



Mother Teresa Str. No. 30  
10000 Prishtinë  
Kosova  
[info@teatrikombetar.eu](mailto:info@teatrikombetar.eu)

TEATRI KOMBËTAR  
Nr. 11  
Data 19.01.2018  
Prishtinë

DATE:	28/12/2017
PËR/ZA/TO:CC:	z. Kujtim Gashi / Ministër në MKRS. z. Feim Hoxha / Ud. Drejtor i Departamentit të Kulturës
CC:	z. Veton Firzi / Sekretar i Përgjithshëm në MKRS.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Kamuran Goranci – Udhëheqës i Divizionit të ASMU
NGA/OD/FROM:	Drejtori i TKK-së Agim Sopi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti vjetor i TKK-së/ 2017



Teatri Kombëtar i Kosovës ka filluar punët e Vitit 2017 me një repertor shumë ambicioz, me infrastrukturë nënligjore relativisht të konsoliduar, me ansamblin rezident pothuajse të kompletuar dhe me një plan të detajuar të punës. Meqenëse gjatë periudhës vjeshtore të vitit paraprak është punuar intensivisht në hartimin dhe aprovimin e repertorit për Skenën e madhe dhe për Skenën e vogël të vogël, e poashtu është punuar intensivisht në hartimin e Legjislacionit sekondar /Rregulloreve bazike/ mbi të cilat do të funksionoj Teatri Kombëtar i Kosovës, menaxhmenti i TKK-së, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, gjatë kësaj periudhe ka evidentuar edhe avaritë dhe pamundësitë e funksionimit normal të TKK-së. Qysh në ditët e para të muajit Janar, është marr vendim dhe ka filluar puna në realizimin e projekteve të reja dhe në hartimin e repertorit /shfaqjeve/ të për çdo nate në TKK.

### **Repertori i vitit 2017**

Udhëheqësi artistik, në bashkëpunim të ngushtë me drejtorin e përgjithshëm dhe me miratimin unanimit të Këshillit Drejtues, ka përzgjedhur repertorin e TKK-së për vitin 2017, të kompozuar nga gjashtë tekste dramash të verifikuara për Skenën e Madhe dhe pesë projekteve të përzgjedhura për Skenën e vogël të vogël. Sikurse edhe në vitin paraprak, TKK ka hartuar një repertor në favor të dramës kombëtare që është edhe obligim fundamental ligjor. Tekstet dramatike të aprovuara për realizim në Skenën e Madhe për Vitin 2017 kanë qenë:

1. **'I ligu për mend'** me tekst të Gjergj Fishtës, regjia Altin Basha
2. **'Bordel Ballkan'** me tekst të Jeton Nezirajt, regjia Andrash Urban
3. **'Aventurat e reja të Don Kishotit'** me tekst të Tariq Ali, regjia Dino Mustafiq
4. **'Arturo Ui'** me tekst të Bertold Brecht, regjia Bekim Lumi
5. **'Njeriu që mungonte'** me tekst të Zymber Kelmendit, regjia Isa Qosja
6. **'Pasioni'** me tekst të Sabri Hamitit, regjia Martin Kochovsky

